



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr.292, datë 16.09.2013

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe
shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të
konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare
- Rezana KONOMI Zv/Kryetare
- Servete GRUDA Anëtare
- Koço BROKA Anëtare
- Iva ZAJMI Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 16.09.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës si pasojë e sjelljes së një/disa ndërmarrjeve”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin në tregun e karburanteve.

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një monitorim në tregun e karburanteve.

Qëllimi i monitorimit në tregun e karburanteve ka qenë evidentimi i ndryshimeve në strukturën e tregut të karburanteve, diezel 10 ppm dhe benzinë, ecuria e çmimeve në treg për të parë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e mundësisë së koordinimit të sjelljes në treg dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese(në rast të ekzistencës) të një ose disa(dominancë kolektive) ndërmarrjeve aktive në tregun përkatës.

Nga të dhënat e administruara si dhe nga analiza e realizuar u konstatua se tregu i importit të naftës 10 ppm dhe benzines paraqitet me ndryshime të theksuara strukturore ku ndërmarrjet kanë ndryshuar ndjeshëm pjesët e tregut gjatë viteve 2010-gusht 2013. Në treg kemi ndërmarrje që kanë dalë nga tregu i importit duke operuar vetëm në tregun e pakicës, sikurse kemi hyrje të reja në treg.

Nga vlerësimi i indeksit të përqëndrimit në tregun e importit të diezelit, vihet re se gjatë 8 mujorit 2013 tregu paraqitet shumë i përqëndruar, por me një ulje të pjesës së tregut që zënë tre(CR3) dhe pesë(CR5) ndërmarrjet më të mëdha në treg.

Treguesit e përqëndrimit në tregun e importit të benzines paraqiten në nivelin më të lartë të një tregu mesatarisht të përqëndruar (800-1800) me një rritje krahasuar me vitet e kaluara. Gjithashtu rritje paraqesin edhe treguesit e përqëndrimit për tre dhe pesë konkurrentët kryesorë, e cila është si pasojë e rritjes së pjesës së tregut të tre ndërmarrjeve më të mëdha në treg.

Çmimi i importit të dieselit dhe benzines ka patur vlerën më të ulët gjatë muajit maj 2013 me trend rritës për muajt në vazhdim, por këto ulje nuk janë reflektuar në çmimet në tregun e pakicës.

Nga analiza e të dhënave mbi volumin dhe çmimin e shitjes me shumicë të karburantëve për vitin 2012, u vu re se nga analiza e çmimit të shitjes në stacionet me logon e tyre, këto çmime kanë patur ulje dhe ngritje, por trendi i ndryshimit të çmimeve për tre ndërmarrje kryesore është i njëjtë. Kjo vërehet veçanërisht pas muajit maj 2012, ç'ka mund të ngrejë dyshimin për një marrëveshje në vendosjen e çmimit. Ndërmarrjet e integruara të pakicës pasqyrojnë politikën e ndërmarrjeve importuese në përcaktimin e çmimit të shitjes së karburanteve nën logon e tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumice të karburanteve për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve në treg.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga janar 2010 deri në gusht 2013.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv/Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R